

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kapetanović nga Nju Jorku: Bashkëpunimi provohet kur politika bëhet e vështirë
ADRESA	https://www.gazetatema.net/politika/kapetanovi-nga-nju-jorku-bashkepunimi-provohet-kur-politika-behet-e-ves-i588315
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 11:24:11 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 11:20:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	35a5cc8ab1684e6dcfd29ab1b2b2b9f09a98f1af2dc0308c93289185fa333180
TEKSTI	f03d93a49763e5217b8e465e953bba138afa5ab434dee466609202e34ed7b11c
PAMJA	cda022c610d2b97f633808e1ecec871d1749a1c39a22af38ea22704423b18da9

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	2469969fbc98e9a200d132a03432fb6abaabe064ae84c6132b32b7934967654c
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9f67fd8f5341aacd98433415ae2bd1fabd75d8584ec60b7ea3d19ca47caca387
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/2469969fbc98e9a200d132a03432fb6abaabe064ae84c6132b32b7934967654c>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



le [Kapetanovic nga Nju Jorku: Bashkëpunimi provohet kur politika bëhet e vështirë](#) - Ligat e medha evropiane kerkojne n fundit

Kapetanović nga Nju Jorku: Bashkëpunimi provohet kur politika bëhet e vështirë



25 Shtator 2026, 13:20Politika TEMA



Nju Jork , Bashkëpunimi rajonal nuk ka shumë vlerë nëse funksionon vetëm kur të gjithë bien dakord. Prova e tij e vërtetë nis pikërisht atëherë kur politika vështirësohet.

Ky ishte mesazhi kryesor i Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit për Bashkëpunim Rajonal (RCC), Amer Kapetanović, në takimin e Ministrave të Punëve të Jashtme të Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECP), të zhvilluar më 24 shtator në Nju Jork, në margjinat e Javës së Nivelit të Lartë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.

“Bashkëpunimi rajonal nuk matet më me atë për të cilën pajtohemi kur politika është e lehtë, por me atë që vazhdon të funksionojë kur politika bëhet e vështirë. Nuk mund të presim një klimë më të mirë politike përpara se të bashkëpunojmë. Pikërisht përmes bashkëpunimit fillojmë ta krijojmë një të tillë”, tha Kapetanović.

Takimi, i organizuar nën kujdesin e kryesive rumune të Nismës së Evropës Qendrore (CEI) dhe SEECP-së, u përqendrua në një pyetje gjithnjë e më të rëndësishme për Evropën Juglindore: çfarë roli duhet të luajnë mekanizmat rajonalë në një kohë kur mjedisi politik dhe ai i sigurisë po bëhen më të ndërlikuar?

Për Kapetanovićin, përgjigjja nuk qëndron në krijimin e institucioneve apo formateve të reja, por në bërjen më funksionale të atyre që ekzistojnë.

Ai veçoi kapitalin njerëzor, ndërlidhjen, qëndrueshmërinë ekonomike dhe shoqërore, përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe gatishmërinë ndaj fatkeqësive si fusha ku bashkëpunimi rajonal mund të prodhojë rezultate konkrete dhe të prekshme për qytetarët.

Në këtë kontekst, Sekretari i Përgjithshëm i RCC-së solli edhe një metaforë për të kundërshtuar idenë se bashkëpunimi rajonal është thjesht një fazë kalimtare deri në anëtarësimin në Bashkimin Evropian.

“Nëse bashkëpunimi rajonal dhe RCC-ja do të ishin një dhomë pritjeje, ajo do të ishte zbrazur prej kohësh. Anëtarësimi ndryshon marrëdhëniet tona institucionale. Nuk e ndryshon gjeografinë tonë”, tha Kapetanović.

Mesazhi është veçanërisht i rëndësishëm për Ballkanin Perëndimor. Integrimi evropian mund të ndryshojë statusin institucional të vendeve të rajonit, por jo faktin se ato do të vazhdojnë të ndajnë kufij, ekonomi, infrastrukturë, burime njerëzore dhe sfida të përbashkëta.

Pikërisht për këtë arsye, sipas Kapetanovićit, bashkëpunimi rajonal duhet parë jo si zëvendësim për integrimin evropian, por si një mekanizëm që e mbështet dhe e bën atë më funksional.

Ministrat e Punëve të Jashtme të SEECP-së mirëpritën kontributin e RCC-së dhe vlerësuan rolin e organizatës në kthimin e angazhimeve politike në iniciativa dhe rezultate konkrete rajonale.

Takimi i Nju Jorkut u zhvillua nën temën “Bashkëpunimi rajonal në një botë në ndryshim: Sigurimi i stabilitetit, qëndrueshmërisë dhe rritjes së qëndrueshme përmes bashkëpunimit të bazuar në besim dhe të orientuar drejt rezultateve”.

Në margjinat e qëndrimit në Nju Jork, Kapetanović zhvilloi edhe një takim me Përfaqësuesin e Posaçëm të Bashkimit Evropian, Peter Sørensen. Në fokus të bisedës ishin zhvillimet në rajon, bashkëpunimi ndërmjet vendeve dhe perspektiva evropiane e Ballkanit Perëndimor.

Ai u takua gjithashtu me Zëvendës Sekretarin e Shtetit për Bashkëpunim Ndërkombëtar të Hungarisë, István Lakatos. Bisedimet u përqendruan në mbështetjen e bashkëpunimit rajonal, ndërtidhjen dhe zhvillimin ekonomik, procesin e integritit evropian dhe mundësitë për bashkëpunim më të ngushtë.

Nga Nju Jorku, mesazhi i Kapetanovićit ishte në thelb i thjeshtë: rajoni nuk ka luksin të presë që politika të bëhet më e lehtë për të bashkëpunuar. Bashkëpunimi duhet të funksionojë pikërisht atëherë kur politika nuk funksionon aq mirë.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

["Të vijojë lufta ndaj korrupsionit" - Nga komandant i NATO-s në ambasador në Tiranë. Media në SHBA: Si e gjen Eric Wendt Shqipërinë](#)

13:10 Politika

[Ministrja i përgjigjet Berishës: Tek Agasi isha bashkë me Argitën](#)

11:20 Politika / 31 komente

[Struktura e re për barnat, Tabaku: Qytetarët paguajnë nga xhepi, qeveria përqendron miliardat në pak duar](#)

10:55 Politika / 7 komente



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.